

Vasilj L. Jovoviq, PhD

Territori i Malit të Zi të sotëm në antikitetin e vonë dhe në mesjetën e hershme

Fakulteti Filozofik Nikshiq, vasiljjovovic@yahoo.com

Abstrakti: Territori i Malit të Zi të sotëm gjatë sundimit romak ishte pjesë e provincës së Ilirikut, më pas e provincës së Dalmacisë, kurse nga viti 297 bën pjesë në përbërjen e provincës së Prevalisit me qendër Shkodrën. Gjatë ndarjes së Perandorisë Romake në vitin 395, provinca e Prevalisit i takoi Perandorisë Romake të Lindjes. Në shekujt në vijim, zona e Gadishullit Ballkanik, dhe si rrjedhojë edhe provinca e Prevalisit, u ballafaqua me sulmet barbare (gotët, avarët, sllavët). Gjatë shekujve VI dhe VII, në kohën e mësymjeve avarë dhe sllavë në territorin e Perandorisë Romake të Lindjes, qeveria perandorake si dhe organizatat kishtare u shkatërruan plotësisht në shumë zona të Gadishullit Ballkanik, përshirë këtu edhe provincën e Prevalisit.

Fjalët kyçe: Prevalis, Shkodra, Mali i Zi, mesjeta.

Me reformat administrative të perandorit Dioklecian në vitin 297, Perandoria Romake u nda në katër prefektura: Orienti, Iliriku, Italia dhe Galia, të cilat u ndanë në dioqeza. Prefektura e Ilirikut ndahej në dioqezën e Maqedonisë dhe në dioqezën e Mëzisë, në kuadër të së cilës, midis krahinave të tjera (të dy Dakitë, Dardania, Mëzia e Epërme dhe e Poshtme), u formua edhe provinca e Prevalisit. Provinca e sapothemeluar e Prevalisit u nda nga provinca e lashtë romake e Dalmacisë në vitin 297, ose diçka më vonë në vitet 305 ose 306. Ndarja e provincës së Prevalisit nga provinca e Dalmacisë u bë për shkak të lidhjeve të vështira të komunikimit nga deti me qytetin e Salonës, qendrën e provincës së Dalmacisë, megjithëse deri në fund të shekullit III Perandoria Romake kishte formuar një rrjet të mirë rrugësh që e lidhnin Salonën me territorin e Malit të Zi të sotëm dhe të Shqipërisë së Veriut. Nën perandorët romakë, Dioklecianin dhe Kostandinin e Madh, provinca e Prevalis-

it i përkiste dioqezës të Mëzisë, rreth vitit 396 dioqezës së Maqedonisë dhe nga viti 400 dioqezës së Dakisë. Kur perandori romak Theodosi e ndau Perandorinë në atë të Lindjes dhe të Perëndimit në vitin 395, provinca e Prevalisit i përkiste Perandorisë Romake të Lindjes dhe u bë provinca e saj kufitare. Në vitin 437, me rastin e martesës së perandorit romak perëndimor Valentian III me Eudokinë (Eudoxia), vajzën e perandorit romak të lindjes Theodosit II, e gjithë prefektura e Ilirikut i përkiste Theodosit II, dhe kështu Prevalisi nuk ishte më një provincë kufitare (Kovačević, 1967: 241-242; Zagarčanin, 2014: 50).

Provinca e Prevalisit kufizohej në perëndim me provincën e Dalmacisë, në veri me provincën e Mëzisë së Epërme, në lindje me provincat e Dardanisë dhe Maqedonisë *Salutaris* dhe në juglindje me provincën e Epirit të Ri. Kufiri perëndimor me gjasë shtrihej nga Budva në veri, duke përkuar me kufijtë e Perandorisë Romake të Lindjes dhe Perëndimit, malin Llovqen, përreth Bokës së Kotorrit (mne. Boka Kotorska) në Krivoshije dhe Nikshiqin e sotëm, dhe më pas nëpër Piva deri ku bashkohen lumenjtë Piva dhe Tara. Në jug dhe në lindje, kufiri kalonte përgjatë lumit Mat, lumit Drini i Zi deri te bashkimi i tij me Drinin e Bardhë dhe me vargmalin e lartë të Sharrit (*Skadrus Mons*) deri tek Ibrit e Epërm (mne. Gornji Ibar). Kufiri verior me gjasë kalonte përmes maleve Durmitor, Sinjajevina, nëpër Kollashin dhe Vasojevički Komovi në Rugovë, Mokra Gora, Podgor dhe Suva planina, deri në luginën e Ibrit. Në krahinën e Prevalisit ishin qytetet bregdetare Ulqini dhe Lezha, dhe qytet-

et kontinentale Doklea dhe Shkodra. Nga letrat e papës romak Leo I të vitit 446 dhe Gregorit I, mund të arrihet në përfundimin se Shkodra ishte kryeqyteti i provincës. Organizimi kishtar përputhej gjithmonë me organizimin shtetëro-administrativ të Perandorisë, përkatësisht, në letërën e papës Leo I, peshkopi i Shkodrës, Seneka II, quhet argjipeshkëv dhe në letërën e Gregorit I përmendet Gjoni, argjipeshkëv i Shkodrës, kështu që nga këto të dhëna mund të konsiderohet se Shkodra ishte kryeqendra e provincës së Prevalisit (Kovačević, 1967: 242).

Provinca drejtohej nga një administrator (*praeses*) me titullin *vir clarissimus* ose *vir perfectissimus*. *Praeses* përzgjidheshin nga radhët e kalorësve dhe u jepeshin edhe tituj të tjerë të lartë si *iudex*, *rector* ose *moderator*. Detyra e *praeses* (*praesidiatus*) konsistonte në kryerjen e funksioneve administrative dhe gjyqësore, por nuk përfshinte funksione ushtarake, sepse me reformat e perandorëve Diokleciani dhe Konstandini I u bë ndarja e autoriteteve ushtarake nga ato civile në provinca (Kovačević, 1967: 243). Punët ushtarake të një ose më shumë provincave drejtoheshin nga *dux*-i. Në fillim nuk kishte ushtri në provincën e Prevalisit, sepse as në provincën e Dalmacisë nuk kishte ushtri që nga koha e perandorit Vespasian. Situata ndryshoi kur provinca e Prevalisit u bë zonë kufitare e Perandorisë Romake të Lindjes, në veçanti kur e gjeti veten në kufi me shtetin armik të Gotëve të Lindjes. Në provincën e Dalmacisë ushtria dhe flota u organizuan gjatë sundimit të perandorit Leo I (457-474). Në atë kohë ka gjasa të jetë organizuar edhe ushtria në Prevalis (Kovačević 1967: 244-245).

Depërtimi i gotëve të perëndimit në fund të shekullit IV dhe në fillim të shekullit V në provincën e Prevalisit nuk la ndonjë gjurmë të qartë arkeologjike, prandaj nuk mund të thuhet me siguri se deri në çfarë mase e kanë plaçkitur dhe shkretuar provincën e Prevalisit (Kovačević 1967: 251-252). Gjysmë shekulli më vonë, gotët e lindjes u shfaqën në kufijtë e Prevalisit (459) dhe, pasi perandori romak i lindjes Leo I ua anuloi subvencionet (*subsides*), shkretuan Ilirikun, depërtuan në Epirin e Ri dhe plaçkitën Durrësin. Pas marrëveshjes me qeverinë perandorake, gotët e lindjes u tërhoqën në Panoni. Pas njëzet vitesh, gotët e lindjes, gjatë luftës me perandorin romak të Lindjes Zeno, depërtuan sërish në Epir në vitin

478, të udhëhequr nga Theodorik Amaliani. Nga Epiri i Ri, gotët e lindjes depërtuan në Prevalis. Në afërsi të Shkodrës është gjetur një kopsë gotike lindore, dyfish e dekoruar me gurë gjysmë të çmuar dhe koka të zogut mitik gotik. Disa filologë shohin etimologjinë e emrit të fisit Hoti dhe toponimet e zonës së Hotit dhe Leqet e Hotit, në anët verilindore të liqenit të Shkodrës, si dëshmi për qëndrimin e gotëve në rrethinën e Shkodrës.

Pas vrasjes së perandorit Julius Nash në Salinë, udhëheqësi gjerman i trupave mercenare në Itali, Odoacer, pushtoi të gjithë Dalmacinë (480-482), dhe kështu ra në kontakt të drejtpërdrejtë me Perandorinë e Lindjes. Duke parë rrezikun nga Odoacer, Zeno, mbreti i Perandorisë së Lindjes, ktheu gotët e lindjes kundër tij, dhe ata nën Theodorik Amalian e shkatërruan shtetin e Odoacerit në një kohë të shkurtër dhe krijuan në Itali shtetin e gotëve të Lindjes (493). Theodoriku pushtoi gjithashtu Dalmacinë, ku perandori romak i lindjes mbeti vetëm një sovran nominal. Në shtetin e tij, Theodoriku përfshiu zonat kufitare perëndimore të provincës së Prevalisit, zonën rreth qytetit të sotëm Nikshiq, ku ndodhej kastrumi romak Anderba, dhe pjesën lindore të provincës së Dalmacisë, Bokën e Kotorrit. Kastrumi Anagast e ka origjinën nga periudha e sundimit të gotëve (Kovačević, 1967: 252-254; Ostrogorski, 1983: 82). Gotët e lindjes pushtuan përkohësisht qytetin e Duklës (489-490) ose shfrytëzuan tërmetin katastrofik të vitit 518 për fushatën e tyre plaçkitëse në Dukla (Kovačević, 1967: 254).

Gotët e lindjes i mbanin ushtarakisht territoret e pushtuara, me gjasë ishin të paktë në numër dhe formuan garnizone ushtarake në kastrume, të ndarë nga popullsia vendase autoktone. Po ashtu, gotët e lindjes ndryshonin nga popullsia vendase në aspektin fetar, sepse ata që në vendlindje e pranuan krishterimin në formën e herezisë ariane, që e predikonte Ariani nga Aleksandria (shek. IV), duke mos njohur unitetin e babait dhe të birit dhe duke mohuar kështu se Jezu Krishti është Perëndi. Gotët e lindjes formuan organizatën e tyre kishtarë dhe komunat e veçanta kishtarë. Kështu, në Salinë, qendrën e pushtetit të tyre në Dalmaci, krahas me ortodoksët, vepron komuna kishtarë ariane (Kovačević, 1967: 255). Rivendosja e autoritetit të plotë perandorak në provincën e Prevalisit ndodhi gjatë sundimit të perandorit bizantin Justiniani I (527-565), kur u rivendos organizata kishtarë (Vu-

jićić, 2007: 31). Nga viti 535 deri në vitin 555 zgjati fushata bizantine kundër mbretërisë së gotëve të Lindjes, e cila përfundoi me pushtimin dhe vendosjen e saj nën sundimin bizantin (Ostrogorski, 1983: 89).

Besohet se në Shkodër, qendrën e provincës së Prevalisit, në fund të shekullit IV u organizua argjipeshkvia. Ipeshkvi e parë të njohur të Shkodrës ishin Basso dhe Senecius, të cilët përmenden në letërën e Papa Siricius rreth vitit 392 (Kovačević, 1967: 257; Vujićić, 2007: 21; Mijović, 1998: 44). Përveç Shkodrës, qendrat peshkopale në Prevalis ishin Dukla dhe Lezha. Ipeshkvi i Duklës, Evandar përmendet si pjesëmarrës në Koncilin e Kalqedonit në vitin 451 (*Evandrus episcopus civitatis Diocliae*) (Mijović, 1998: 39). Në fund të shekullit IV, provinca e Prevalisit u bashkua prefekturës së Ilirikut të Lindjes, në të cilën u formua një krahinë kishtare me seli në Selanik, ekzarku i së cilës kishte të drejta patriarkale ndaj argjipeshkve dhe ipeshkve vartës rajonalë. Kur pas Enotikonit të perandorit romak të Lindjes, Zeno, në vitin 481, ngjau përçarja ndërmjet Romës dhe Konstandinopojës, situata në Ilirikun e Lindjes ishte e parregulluar në marrëdhëniet midis Patrikanës së Konstandinopojës dhe Ipeshkvisë Ilire dhe Kurisë Romake dhe Ekzarkatit të Selanikut. Në atë kohë, ipeshkvi e Prevalisit u lanë të vendosin vetë sa i përket çështjeve kishtare, derisa gjatë sundimit të perandorit Justin I (518-527) erdhi deri te ribashkimi në mes kishës së lindjes dhe asaj të perëndimit. Me formimin e Argjipeshkvisë Justiniana Prima në bazë të novelës (ligjit) 19 të Perandorit Justinian, më 14 prill 535, provinca e Prevalisit kaloi nën juridiksionin e saj. Në Koncilin e Pestë Ekumenik në Konstandinopojë në vitin 553, Foka, ipeshkëvi i Shkodrës, paraqitet si përfaqësues i Justiniana Prima dhe mbështeste politikën e perandorit Justinian (Kovačević, 1967: 257-261).

Sa i përket rrethanave kulturore, pozita gjeografike e provincës së Prevalisit, e cila ndodhej në kufirin e sferës lindore dhe perëndimore, solli ndërthurje dhe ndikime të dyanshme të Lindjes dhe Perëndimit në jetën kulturore të provincës, që u pasqyrua si në arkitekturë ashtu edhe art. Në aspektin gjuhësor, në periudhën e antikitetit të vonë provinca e Prevalisit i përkiste sferës latine. Lumi Drin, ose rruga e lashtë romake *Via Egnatia*, ishte në atë kohë kufiri midis gjuhëve dhe qytetërimeve latine dhe greke. Në brendësi të provincës së Preval-

isit, si dhe në Epirin e Ri fqinj, romanizimi ishte sipërfaqësor (Hrabak, 1991: 91). Në provincën e Prevalisit, përveç kishave në Dukla, Tivar dhe Bokën e Kotorrit, njihen edhe disa objekte kishtare të shekujve V dhe VI, siç janë bazilikat në Budimlje, Kolovrat në Lim dhe në fortesën pranë fshatit Martiniqi afër Spuzhit (Kovačević, 1967: 267-271). Mbetjet e një bazilike paleokristiane u zbuluan nën kompleksin e kishës së sotme të Shën Pjetrit (mne. Sveti Petar) në Bijello Polje (Vujićić, 2007: 34). Veprimtaria ndërtimore më intensive në provincën e Prevalisit si dhe në provincat tjera të Perandorisë, ishte gjatë sundimit të perandorit Justinian dhe u pasqyrua në ndërtimin e fortifikimeve ushtarake dhe objekteve sakrale. Bazilikat u ndërtuan kryesisht në qytete që ishin seli ipeshkvnore ose argjipeshkvnore (Vujićić, 2007: 21, 31). Në fillim të shekullit VI vjen deri te braktisja e qyteteve si qendra agrare dhe shndërrimi i pronave ipeshkvnore në qendra të reja agrare.

Sipas Pavle Mijovićit, kështu ndodhi kudo në bregdet, në rrethin e Duklës, në rrethin e Nikshiqit dhe në rrethe dhe zona të tjera të krahinës së Prevalisit. Mbetjet e një bazilike të hershme bizantine u gjetën afër Beranit në fshatin Budimlji (Mijović, 1998: 47).

Shkatërrimi i provincës së Prevalisit nga gotët e lindjes shkaktoi dëme në organizimin e kishës. Gjatë shkatërrimit të Duklës nga gotët u shkatërruan dy bazilika të krishtera, njëra prej të cilave ishte kishë katedrale. Njëra prej tyre u restaurua në shekullin IX, si kishë në formë kryqi. Gjatë kësaj periudhe, qendra e kishës u zhvendos nga Dukla në lokalitetin Zllatica në Doljani, ku u zbuluan dy kisha pranë njëra-tjetrës: një bazilikë e gjerë tre-anijatëshe dhe një kishë trikonike (Kovačević, 1967: 263).

Organizimi kishtar në provincën e Prevalisit u shpërbë si pasojë e dyndjes së avarëve dhe të sllavëve në fund të shekullit VI. Dy valët e para të sllavëve përfunduan në Epirin e Vjetër dhe të Ri dhe në Greqi, por nuk e anashkaluan as Prevalisin. Në vitin 548, sllavët arritën në Durrës, kurse në v. 587-88, pas rrethimit të dështuar të Selanikut, ata u përhapën në të gjithë Epirin e Vjetër dhe Greqi. Kjo valë sllave u përhap edhe në veri të lumit Vojushë. Ipeshkvi i Lezhës duhej ta lëshonte dioqezën e tij dhe të strehohej përkohësisht në Itali, ku qëndroi që në mesin e vitit 592 (Hrabak 1991: 92). Në vitin 599 ipeshkvi i Lezhës u largua përfundimisht

nën sulmin e pushtuesve dhe u vendos në Itali, kurse ipeshkvi i Risanit përmendet për herë të fundit në vitin 595. Në burimet historike ekzistenca e organizimit kishtar në Shkodër dhe Dukla përmendet për herë të fundit në vitin 602. Vala e tretë e madhe sllave (rreth vitit 615) rezultoi me popullimin e provincës së Prevalisit nga sllavët. Gjatë shekullit VII, veçanërisht gjatë dy dekadave të para, me thyerjen e pushtetit shtetëror në Ballkan, e krahas me të edhe në provincën e Prevalisit, me shkatërrimin e qyteteve, shpërnguljet e mëdha të popullsisë, ndodhën ndryshime rrënjësore në këto treva, që rezultuan në shkatërrimin e organizimit kishtar, që u ripërtëri vetëm në fillim të shekullit IX (Kovačević, 1967: 263; Hrabak, 1991: 92).

Depërtimi i sllavëve pati rëndësi dhe ndikim të madh për Gadishullin Ballkanik. Me kalimin e kohës, sllavët vërshuan në tërë gadishullin deri në detet Adriatik dhe Egje dhe Gjirin e Korinthis. Në fillimet e sundimit të Justinianit sllavët, së bashku me bullgarët, filluan inkursionet e vazhdueshme në provincat ballkanike të Perandorisë, përkundër fortifikimeve të forta në Danub dhe brendësi. Mirëpo, për shkak se ushtria bizantine ishte e zënë me fronte të tjera, në Afrikë, Itali dhe Spanjë, nuk kishte kush t'i mbronte krahinat ballkanike. Sllavët fillimisht u mjaftuan me plaçkitjen e tokave bizantine dhe kthimin me plaçkë në trojet e tyre përtej Danubit. Mirëpo me kalimin e kohës ata filluan të vendosen përgjithmonë në Gadishullin Ballkanik (Ostrogorski, 1983: 90-91). Gjatë sundimit të perandorit bizantin Mauritius (582-602), për shkak të sulmeve të shpeshta nga sllavët, vazhduan trazirat në Gadishullin Ballkanik, të cilat u intensifikuan me ardhjen e avarëve në ultësirën e Panonisë. Pasi i nënshtroan sllavët ndaj pushtetit të tyre, filluan me sulme në territorin e Perandorisë, duke shembur sistemin bizantin të mbrojtjes. Gadishulli Ballkanik iu la sllavëve në dorë (Ostrogorski, 1983: 99; Mijović, 1991: 69-83). Rreth vitit 614 u shkatërrua Salona, qendra e administratës bizantine në Dalmaci, dhe u shembën qytetet më të rëndësishme në brendësi të Gadishullit Ballkanik, gjë që e shkatërroi qeverinë dhe qytetërimin bizantin në këto treva. Ngjashëm ndodhi edhe me provincën e Prevalisit, ku vetëm disa fortifikata urbane mbetën nën sundimin bizantin, si Butua (Budva), Scodra (Shkodra) dhe Lisus (Lezha), të futura brenda mureve mesjetare (Ostrogorski, 1983: 110; Dragolović, 1991: 35). Pjesa më e madhe e Gadishullit

Ballkanik, veçanërisht brendësia e tij, ishte në duart e disa fiseve sllave. Shkrimtarët bizantinë këto zona i quajnë "sklavinia", të cilat në fakt janë jashtë "juridiksionit" të pushtetit bizantin, por që akoma nuk i kanë organizimet e veta shtetërore (Ostrogorski, 1970: 10-11; Ostrogorski, 1983: 111).

Gjatë antikitetit të vonë, territori i Malit të Zi të sotëm ishte pothuajse tërësisht, me përjashtim të Bokës së Kotorrit, pjesë e provincës së Prevalisit (nga viti 297), me qendër Shkodrën. Provinca e Prevalisit ishte pa garnizone ushtarake derisa u bë zona kufitare e Perandorisë Romake të Lindjes. Nga fundi i shekullit IV, në provincën e Prevalisit u themelua organizata kishtarë. Për shkak të pozicionit të saj kufitar, në provincën e Prevalisit vjen deri te përzjerja dhe ndërthurja e ndikimeve kulturore lindore dhe perëndimore. Provinca e Prevalisit u dëmtua rëndë nga pushtimi i gotëve të lindjes, mirëpo në shekullin VI, gjatë sundimit të perandorit Justiniani I, në provincë nisi rindërtimi i qyteteve dhe i organizimit të kishës. Në fund të shekullit V dhe në fillim të shekullit VI, për shkak të dyndjeve sllavo-avare në Gadishullit Ballkanik, qytetet dhe organizatat kishtarë në provincën e Prevalisit u shkatërruan për një periudhë të gjatë kohore.

Literatura

Vujičić, R. (2007). *Srednjovjekovna arhitektura i slikarstvo Crne Gore*. Podgorica: CID.

Драгојловић, Д. (1991). Етничке промене на тлу позноримске провинције Превалитане. Нё: *Становништво словенског поријекла у Албанији (Зборник радова са Међународног научног скупа одржаног на Цетињу 21, 22. и 23. јуна 1990)* (35-42). Титоград: Историјски институт СР Црне Горе.

Загарчанин, М. (2014). О Скадру и Доклеји у провинцији Превалис на основу археолошких свједочанстава. *Историјски записи*, (1-2), 49-66.

Ковачевић, Ј. (1967). Провинција Превалис. Нё: *Историја Црне Горе, Књига Прва, Од најстаријих времена до краја XII вијека* (241-277). Титоград: Редакција за историју Црне Горе.

Мијовић, П. (1991). Команска култура и питање доласка Словена у Превалис. Нё: *Становништво словенског поријекла у Албанији (Зборник радова са Међународног научног скупа одржаног на Цетињу 21, 22. и 23. јуна 1990)* (69-83). Титоград: Историјски институт СР Црне Горе.

Мијовић, Р. (1998). *Od Dokleje do Podgorice*. Cetinje: Centralna narodna Biblioteka Republike Crne Gore „Đurđe Crnojević“.

Острогорски, Г. (1970). *Византија и Словени*. Београд: Просвета.

Острогорски, Г. (1983). *Историја Византије*. Београд: Просвета.

Храбак, Б. (1991). Ширење арбанашких сточара по равницама и словенски ратари средњовековне Албаније. Нё: *Становништво словенског поријекла*

у Албанији (Зборник радова са Међународног научног скупа одржаног на Цетињу 21, 22. и 23. јуна 1990) (85-130). Титоград: Историјски институт СР Црне Горе.